



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Nr. 01/37

Datë: 24.09.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, nenit 93 paragrafi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 5 paragrafit 2.4, nenit 6 paragrafit 1, nenit 10 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, në zbatim të rekomandimeve të IKShPK-së me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator 2021 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19**

**A. [Zbatimi territorial]**

1. Ky vendim zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

**B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës]**

2. Çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës, duhet të posedoj një nga dëshmitë e mëposhtme:
  - 2.1. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19;
  - 2.2. Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
  - 2.3. Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitrupave serologjik -IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
  - 2.4. Test i shpejtë antigenik negativ jo më i vjetër se 48 orë.
3. Nga data 13 tetor 2021, çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës, duhet të posedoj certifikatën e vaksinimit të plotë apo ndonjërin nga dëshmitë e cekura në pikën 2.2 deri 2.4.
4. Shtetasit e Republikës së Kosovës, si dhe personat me leje qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm në Kosovës, të cilët hyjnë në Republikën e Kosovës, në rast se nuk posedojnë një nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.4, duhet të vetë-izolohen për 7 ditë. Këta persona duhet të plotësojnë deklaratën nën betim për vetë-izolim në pikën kufitare përkatëse.

5. Nga kërkesa për të poseduar ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.4 , lironen:

- 5.1. Personat të cilët hyjnë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohen nga Kosova brenda tre (3) orësh përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda tre (3) orësh;
- 5.2. Personat, të cilët punojnë si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga COVID-19;
- 5.3. Shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë dalë jashtë Kosovës në 12 orët e fundit;
- 5.4. Qytetarët e huaj, të cilët kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtarë, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda pesë (5) orësh;
- 5.5. Diplomatët e huaj, të akredituar në Kosovë;
- 5.6. Personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare.

#### **C. [Mbrojtja dhe siguria në punë]**

6. Të gjithë punonjësit e institucioneve publike, si dhe personeli i ndërmarrjeve publike në pronësi të Qeverisë apo të një komune, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në ambientet e punës.
7. Nëpunësi më i lartë administrativ i çdo institucioni publik është i obliguar të caktojë një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërs nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.
8. Nga data 13 tetor 2021, punonjësit/personeli sipas pikës 6, duhet të posedojnë certifikatën e vaksinimit të plotë apo ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.2 deri 2.4.

#### **Ç. [Masat e përgjithshme të mbrojtjes dhe higjenës]**

9. Obligohen institucionet publike e private, si dhe subjektet tjera, të mbajnë dezinfektues për duar dhe një sasi të maskave në vende të qasshme në hyrje të objektit si dhe në ambientet e brendshme.
10. Obligohen institucionet publike e private, si dhe subjektet tjera që në hyrje të çdo objekti të vendosin shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga COVID-19, përfshirë shenjën e ndalimit të hyrjes në objekt pa maska, respektimin e distancës.
11. Obligohen përgjegjësit e institucioneve publike e private dhe subjektet e tjera që të kryejnë dezinfektimin dhe ajrosjen e hapësirave të mbyllura.
12. Bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është obligative në të gjitha rastet, përveç:
  - 12.1. Gjatë ngasjes së automjetit vetëm, apo kur në automjet janë prezentë ekskluzivisht anëtarët e ngushtë të familjes;
  - 12.2. Gjatë vraptit, çiklimit dhe ushtrimeve fizike;
  - 12.3. Gjatë ngrënies apo pijes.
13. Ndalohet hyrja në ambientet e mbyllura pa maskë.
14. Obligohen të gjitha institucionet publike dhe private që të përcaktojnë një punonjës të monitoroje zbatimin e masës të përcaktuar në pikën 13.

#### **D. [Kufizimi i qarkullimit]**

15. Kufizimi i qarkullimit të qytetarëve vazhdon të jetë nga ora 22:00 deri në ora 05:00, përvetës:
  - 15.1. Rasteve të natyrës urgjente (për të kërkuar ndihmë mjekësore, blerje të barnave, për të ofruar kujdes ose ndihmë mjekësore, për të shhangur dëmtimin ose për t'i shpëtuar një rreziku lëndimi);
  - 15.2. Qarkullimit për personelin shëndetësor, të sigurisë dhe operatorët që kryejnë punë apo shërbime publike;
  - 15.3. Personelin e ndërrimit të natës të operatorëve ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zinxhirit të furnizimit (përfshirë transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të veçantë nga sistemi EDI i Administratës Tatimore të Kosovës;
  - 15.4. Personat të cilët ofrojnë dëshmi se duhet të janë në aeroport gjatë orarit të kufizimit të qarkullimit, për shkak se kanë për të udhëtuar përmes aeroplani;
  - 15.5. Personave ndaj të cilët aplikohet leja e veçantë e përkohshme që lëshohet nga Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas pikës 17, për shkak të domosdoshmërisë së qarkullimit gjatë orës policore.
16. Obligohen punëdhënësit të sigurojnë që punëtorët e tyre që i nënshtronen kufizimit nga pika 15 të kenë kohë të mjaftueshme për të udhëtuar në banesat e tyre.
17. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme mundet që të lëshojë leje të veçantë, për persona të cilët ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për domosdoshmërinë që kufizimi i qarkullimit të orarit të ju zgjatet përkohësisht.

#### **Dh. [Institucionet e arsimit]**

18. Procesi mësimor në institucionet parashkollore dhe të qëndrimit ditor vazhdon në mënyrë të irregullt.
19. Procesi mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar zhvillohet sipas skenarëve përkatës të përcaktuar në udhëzuesin për institucionet e arsimit, mirëpo parakusht për mësimin me prani fizikë është prania e jo më shumë se 20 nxënësve për klasë. Nëse në një klasë janë më shumë se 20 nxënës, mund të punohet me skenarin A (me klasë të përgjysmuar) ose me skenarin B (mësim i kombinuar, ku një pjesë e nxënësve e ndjekin mësimin në distancë. Përzgjedhja e nxënësve që do ndjekin mësimin në distancë (online) bëhet me rotacion çdo javë).
20. Procesi mësimor në institucionet publike dhe private universitare zhvillohet sipas udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i personave të lejuar në një klasë mundëson në mënyrë rigorozë mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave.
21. Studentët në mënyrë që të ju mundësohet regjistrimi në konvikt duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.
22. Studentët në institucionet publike dhe private universitare duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4., në mënyrë që të ju lejohet hyrja në objektin e institucionit.
23. Stafi në të gjitha institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, duke përfshirë institucionet parashkollore dhe të qëndrimit ditor, duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që të ju lejohet hyrja në objektin e institucionit.
24. Nëpunësi më i lartë i çdo institucioni sipas pikës 18, 19 dhe 20, është i obliguar me vendim të caktojë një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërs nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

25. Të gjitha institucioneve publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskursionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor apo të nxënësve – studentëve.

**E. [Paraqitja për skemat sociale dhe pensionale]**

26. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve udhëzohet të lirojë të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që menaxhohen nga MFPT-ja nga paraqitja e rregullt në zyrat përkatëse për qëllime të evidentimit, siç kërkohet me ligjet përkatëse..

**F. [Kufizimi i mbledhjeve publike dhe private]**

27. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë vendim, lejohen grumbullimet në ambiente të mbyllura deri në njëzet (20) persona (punëtori, mbledhje, seminare, trajnime apo grumbullime tjera). Obligohet që pjesëmarrësit të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që të ju lejohet hyrja në këto ambiente, si dhe organizatori obligohet të siguroj distancën fizike prej 1.5 metër në mes të personave dhe kontrollimin e dëshmive përkatëse.

27.1 Mbledhjet e Kuvendit dhe të Qeverisë lejohen pavarësisht numrit të personave, duke u respektuar mbajtja e maskave dhe distanca fizike prej 1.5 metrash në mes të personave.

28. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Shëndetësisë mundet që të lëshojë leje të veçantë, që tejkalon numrin prej njëzet (20) persona, për ngjarje të rëndësisë së veçantë në funksion të interesit publik.
29. Lejohen grumbullimet dhe ngjarjet kulturore në ambiente të jashtme deri në pesëdhjetë (50) persona (publiku). Organizatori obligohet të sigurojë mbajtjen e distancës fizike prej 1.5 metër në mes të personave.

30. Pavarësisht pikës 27 dhe 29, për koncerте dhe festivalе vlen pika 33.

31. Mbajtja e pritjes për ngushëllim/kryeshëndoshë ndalohet.

32. Lejohen funeralet vetëm me pjesëmarrje të familjes së ngushtë, duke siguruar që pjesëmarrësit të mbajnë distancë fizike prej 1.5 metër nga njëri-tjetri.

**G. [Ndalimi i veprimtarive dhe organizimeve të caktuara]**

33. Pavarësisht numrit të personave, ndalohet veprimtaria e klubeve të natës si dhe organizimi i festivaleve, koncerteve, ekskursioneve, pelegrinazheve, dasmave, fejesave, ahengjeve familjare dhe shoqërore, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

**Gj. [Gastronomia]**

34. Shërbimet e gastronomisë lejohen të zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me udhëzuesin përkatës.
35. Nga data 27 shtator 2021, klientët dhe stafi i gastronomisë duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.4 në mënyrë që t'u lejohet hyrja në hapësirat e mbyllura të lokaleve.
36. Në lokalet e gastronomisë është e obliguar të caktohet një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërs nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

37. Nga data 27 shtator 2021, lejohet shfrytëzimi i hapësirave të mbyllura deri në 50% e kapacitetit të hapësirës. Në hapësirat e hapura lejohet shfrytëzimi deri në 70% e kapacitetit të hapësirës. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku shërbehet ushqimi dhe pijet.
38. Kuptimi i shprehjes ‘hapësirë e hapur’ dhe ‘hapësirë e mbyllur’ ka të njëjtin kuptim me Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.
39. Klientët duhet të qëndrojnë ulur në çdo kohë në kuadër të lokaleve të shërbimeve të gastronomisë në të cilën lejohet shërbimi i ushqimit apo pijeve, përvèç:
  - 39.1. Gjatë hyrjes apo daljes nga ambienti i lokalit;
  - 39.2. Ndërsa paguan porosinë;
  - 39.3. Gjatë shkuarjes apo kthimit nga tualeti;
  - 39.4. Kur është e nevojshme për qëllime të shëndetit dhe sigurisë.
40. Në rastet nga pika 39.1 deri 39.4 është e obliguar bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën.
41. Shërbimet e gastronomisë lejohet të zhvillojnë aktivitetin e tyre nga ora 05:00 deri në orën 21:30.
42. Muzika lejohet vetëm deri në orën 21:00.
43. Përgjegjësit e lokaleve duhet të sigurohen që distanca ndërmjet klientëve në tavolina të ndryshme të jetë së paku një (1) metër.
44. Pjesa e prapme e një karrigeje, me pjesën e prapme të karriges tjetër duhet jenë në distancë së paku një (1) metërshe.
45. Në hapësirat e mbyllura lejohen deri në 4 persona në tavolinë. Në rast se tavolinat janë më të mëdha se dy (2) metra, atëherë parakusht është kufizimi prej pesë (5) persona në 10 m<sup>2</sup>.
46. Në hapësirat e jashtme lejohen deri në gjashtë (6) persona në tavolinë apo banak.
47. Çdo tavolinë duhet të jetë e pajisur me dezinfektues që përbajnjë së paku 60% alkool.
48. Shërbimi “dërgesë me porosi” lejohet të funksionojë edhe pas orës 22:00, pas pajisjes me leje të veçantë nga sistemi EDI (ATK).

#### ***H. [Qendrat tregtare dhe operatorët e tjerrë ekonomikë]***

49. Lejohet veprimtaria e qendrave tregtare sipas udhëzuesit përkatës.
50. Obligohen të gjithë operatorët, të cilët për veprimitari ekonomike e kanë tregtinë me shumicë dhe pakicë, që të përcaktojnë numrin maksimal të klientëve në lokal në të njëjtën kohë sipas rregullit - 1 person për 8 m<sup>2</sup>. Këta operatorë obligohen të shënojnë në hyrje numrin maksimal të klientëve të lejuar në të njëjtën kohë. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku lejohen të qëndrojnë klientët.
51. Klientët dhe stafi në qendra tregtare dhe qendra të thirrjeve (call center) duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në objekt.
52. Në qendrat tregtare dhe qendrat e thirrjeve (call center) është e obliguar të caktohet një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjëres nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

## *I. [Puna me palë]*

53. Nga data 27 shtator 2021, në institucionet publike/private apo biznese, punonjësit/personeli i cili ka punë me palë/kontakt të drejtëpërdrejtë me klientë (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, berberë, punonjësit në markete dhe banka etj.), duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në objekt. Obligohet të caktohet një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.
54. Personi përgjegjës i institucionit publik apo privat dhe i operatoreve ekonomikë, obligohet që të ndalojë rreshtimin apo tubimin brenda dhe jashtë ambientit të punës/biznesit, përveç nëse mbahet distancë fizike prej të paktën 1.5 metra nga grupet e tjera të personave.

## *J. [Transporti publik]*

55. Ndalohet hyrja në mjetet e transportit publik pa maskë.
56. Operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve lejohen të punojnë duke shfrytëzuar 50% të kapacitetit të ulëseve.
57. Në taksi lejohen të udhëtojnë deri në dy (2) udhëtarë.

## *K. [Teatrot, bibliotekat, etj.]*

58. Bibliotekat, muzetë, kinematë, teatrot, orkestrat, ansamblat, baleti qendrat rinore, qendrat e kulturës me grupe apo institucionet tjera të ngjashme vartëse të MKRS-së apo të Komunave, lejohet të punojnë duke shfrytëzuar 50% të kapacitetit të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse. Obligohet mbajtja e maskës dhe distancës fizike prej 1.5 metrash në mes të personave.
59. Shfrytëzuesit e veprimtarive sipas pikës 58, duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në objekt.
60. Në veprimtaritë sipas pikës 58, duhet të caktohet me vendim një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

## *L. [Sporti dhe rekreacioni]*

61. Lejohen organizimi i garave sportive dhe stërvitjeve përkitazi me protokollet dhe rekomandimet e organizatave botërore për organizimin e ngjarjeve sportive dhe me masat mbrojtëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
62. Numri i pjesëmarrësve në garë (sportistë, klube, zyrtarë, dhe pjesëmarrës tjerë të nevojshëm për zhvillimin e garës) përcaktohet nga federatat sportive duke respektuar masën e distancës dhe masat tjera mbrojtëse.
63. Në aktivitetet garuese në hapësira të mbyllura lejohet prania e shikuesve deri në 10% të kapacitetit të objektit apo hapësirës sportive (stadium, salla sportive, pishina, hapësira të tjera të mbyllura) duke respektuar masën e distancës prej 1.5 metra dhe masat tjera mbrojtëse.
64. Në aktivitetet garuese në hapësira të jashtme lejohet prania e shikuesve deri në 30% të kapacitetit të objektit apo hapësirës sportive (stadium, salla sportive, pishina, hapësira të tjera të mbyllura) duke respektuar masën e distancës prej 1.5 metra dhe masat tjera mbrojtëse.

65. Shikuesit në aktivitetet garuese në hapësira të mbyllura apo të jashtme, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.
66. Organizatorët e garës janë të obliguar të caktojnë persona përgjegjës për kontrollimin e posedimit të ndonjërës nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.4, si dhe të ndërmarrin masat specifike, në përputhshmëri me protokollet ndërkombëtare, për menaxhimin e masës (tifozëve) para, gjatë dhe pas hyrjes në hapësirën sportive.
67. Lejohet shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme për aktivitete individuale rekreative. Klientët dhe stafi, duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e përcaktuara në pikën 2.1 deri 2.4 të këtij vendimi.
68. Çdo fitnes, palestër dhe i ngjashëm është i obliguar të caktojë të paktën një punonjës i cili do të kontrollojë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.
69. Shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme, bëhet në proporcion 1 klient në 10 m<sup>2</sup>.
70. Obligohen vendosja e shenjave informuese dhe dezinfektuesve (apo mjeteve të tjera për pastrimit) në secilën pajisje të fitnesit me qëllim të vetëdijësimit dhe dezinfektimit të tyre nga secili klient pas përdorimit.

#### **LL. [Banjat termale]**

71. Për të hyrë në banja termale, klientët dhe stafi duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e përcaktuara në pikën 2.1 deri 2.4 të këtij vendimi. Obligohen caktimi i të paktën një punonjës i cili do të kontrollojë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

#### **M. [Tregjet dhe therja e kafshëve]**

72. Tregjet publike të automjeteve, kafshëve dhe shpezëve lejohet të zhvillojnë veprimtarinë duke shfrytëzuar 30% të kapacitetit të hapësirës/sipërsaqeve të objekteve përkatëse. Obligohen mbajtja e maskës dhe vendosja e tezgave në distancë fizike prej të paktën 2 metra.

#### **N. [Të dhënat personale dhe mënyra e kontrollimit të dëshmive sipas pikës 2.1 deri 2.4]**

73. Caktimi i personave të autorizuar apo punonjësve të autorizuar për kontrollimin e dëshmive sipas pikës 2.1 deri 2.4, bëhet përmes vendimit ku përcaktohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar.
74. Prezantimi i dëshmive të përmendura në pikat 2.1 deri 2.4, bëhet në një formë e cila nuk lejon që personat e autorizuar ose shërbimet e autorizuara për të kontrolluar posedimin e tyre, t'i mbajnë, t'i ruajnë, t'i regjistrojnë apo përpunojnë të dhënat që përbëhen në dëshmi në çfarëdo forme, përpos nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij në formë të shkruar për përpunimin e këtyre të dhënave.
75. Personat e autorizuar dhe të caktuar me emër, për të kontrolluar dëshmitë përmendura në pikat 2.1 deri 2.4, në rastet kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij në formë të shkruar për përpunimin e këtyre të dhënave, nuk lejohen t'i mbajnë të dhënat ose ripërdorin ato për qëllime të tjera, përvç për konstatimin e posedimit të dëshmive, në interes të shëndetit publik dhe për qëllimet e vetme për të luftuar përhapjen e pandemisë COVID-19.

*Nj. [Udhëzuesit dhe sqarimet]*

76. Obligoget Ministria e Shëndetësisë që të nxjerrë udhëzuesit e përkohshëm, të përgjithshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, si në vijim:
- 76.1. Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e COVID-19;
  - 76.2. Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
  - 76.3. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të të gjitha niveleve;
  - 76.4. Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
  - 76.5. Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varriime, punëtori dhe aktivitete kulturore,
  - 76.6. Udhëzues i Përkohshëm për fitnesë, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
  - 76.7. Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik;
  - 76.8. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
  - 76.9. Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
  - 76.10. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj;
77. Udhëzuesit nga pikë 76 janë të detyrueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohen.
78. Obligoget Ministria e Shëndetësisë që në rast nevoje të nxjerr sqarime për pikat e këtij vendimi.

*O. [Zbatimi]*

79. Obligoget Ministri i Shëndetësisë, AUV dhe Policia e Kosovës, që në bashkëpunim me shtabet emergjente komunave, të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi dhe të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raport favor (çdo të premte deri në orën 16:00).
80. Obligoget Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK dhe IKShPK të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportin favor (çdo të premte deri në orën 16:00) për zbatimin e masave, gjendjen në institucionet shëndetësore, gjendjen epidemiologjike si dhe parashikimet për dy javët në vijim.
81. Obligoget Ministria e Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, në territorin e Republikës së Kosovës të nxjerrë vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK-së.
82. Obligoget Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e masave, vendimeve të tjera dhe udhëzuesve përkatës në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
83. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.
84. I vetmi autoritet që mund të interpretojë këtë vendim është Ministria e Shëndetësisë, ndërkarakq çdo institucion tjetër mund të ofrojë sqarime për kategoritë respektive për të cilat aplikohet ky vendim, vetëm pas miratimit të atij sqarimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

**P. [Shfuqizimi i vendimit Nr. 01/35]**

85. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/35, i datës 12.09.2021.

**Q. [Hyrja në fuqi]**

86. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Masat për ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen nga COVID-19 janë provuar si jetike për të kufizuar transmetimin e COVID-19 dhe për të zvogëluar vdekjet. Sipas raporteve të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, situata epidemiologjike me COVID-19, në Kosovë vazhdon të jetë e rëndë.

Në një situatë të tillë, duke ju referuar të dhënave aktuale mbi situatën epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK - së, Qeveria ka ndërmarrë masa të cilat për qëllim kryesor kanë ruajtjen e shëndetit publik si dhe parandalimin e shpërndarjes së COVID-19.

Duke konsideruar se në gjendjen e njohurive shkencore në dispozicion, rreziqet e transmetimit të virusit COVID-19 zvogëlohen në mes të njerëzve që janë vaksinuar, shëruar së fundmi apo që sa po kanë rezultuar negativ ndaj pranisë së virusit COVID-19, Qeveria ka ndërmarrë masa kufizuese, me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të shpërndarjes së COVID-19, në aktivitetet dhe bizneset të cilat bashkojnë një numër të madh njerëzish në të njëtin vend, dhe në të cilat ruajta e distancës fizike është e vështirë dhe kështu paraqesin një rrezik në rritje të transmetimit të virusit.

Masat e ndërmarra janë proporcionale me rreziqet shëndetësore të shkaktuara dhe të përshtatshme me rrethanat e kohës dhe vendit, si dhe të bazuara në autorizimet e Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës. Masat e ndërmarra përmes këtij vendimi nuk përcaktojnë, në asnjë rast obligimin e vaksinimit të detyrueshëm, duke qenë se kufizimet e vendosura ndaj publikut mund të përbushen me paraqitjen e dëshmisë së statusit të vaksinimit, të rezultatit të një testimi që arrin në përfundimin se personi nuk është i infektuar me COVID-19, ose se personi është shënuar nga COVID-19 dhe ka antitrupa të mjaftueshëm.


Vendimi për masat kundër COVID-19 është bazuar në vlerësimin e situatës së intensitetit të transmetimit dhe kapacitetit të sistemit shëndetësor për t'u përgjigjur, por duke i vlerësuar ato edhe nën dritën e efekteve të këtyre masave që mund të ketë në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë dhe individëve.

Ministria e Shëndetësisë ka bashkërenduar vendimmarrjen me palët e interesit, të cilat kanë qenë të ndikuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga pandemia. Qeveria vëren se këto palë kanë ushtruar të drejtën e tyre për ndikim demokratik në vendimmarrje, në përputhje me nenin 45.3 të Kushtetutës.

Masat e përcaktuara në këtë vendim si dhe afatet kohore shërbejnë që situata epidemiologjike të mbahet nën kontroll por nuk përjashtojnë mundësinë e ndërmarrjes së masave të reja kufizuese apo lehtësuese.

Prandaj, në bazë të rekomandimeve të dhëna nga IKShPK-së, ministritë e linjës, palët e interesit dhe ekspertët përkatës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/37

Datë: 24.09.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 8, paragrafi 1.25 të Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrite e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë, për subvencionim në formë mbështetjeje ndaj të gjithë të angazhuarve në Qendrat e Vaksinimit kundër COVID-19 nga data 11.09.2021 deri me datë 10.10.2021 me një shumë të caktuar sipas skemës bashkëngjitur këtij vendimi, pavarësisht nga statusi i stafit shëndetësor i angazhuar në proces të vaksinimit.
2. Mjetet e nevojshme në shumë prej 598,500.00 € (pesëqind e nëntëdhjetëtetëmijëepesëqind) euro për zbatimin e këtij vendimi alokohen përmes kodit të dedikuar për pandemi (00099), nga buxheti ekzistues i Ministrisë së Shëndetësisë me kod 206, Programi 903 Aftësimi Specialistik, kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nën-kategoria Transfere me kod 2200 në Planin Kontabël, përkatësisht 22200-Pagesa për Përfituesit Individual.
3. Listat e përfituesve të subvencionimit sigurohen nga menaxheri i ekipit-komisionit për mbikëqyrjen e procesit teknik të vaksinimit kundër COVID-19 në Republikën e Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Nr. 03/37

Datë: 24.09.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 pika 6 të Ligjit Nr.07/L-041 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrite e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve buxhetore në shumë prej: 2,025,888.00 €, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me kod 212, nën programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga Projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në 24 (njëzet e katër) projekte kapitale në përputhje me 24 (njëzet e katër) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në këto projekte te reja, konform shumave të cekura si në vijim;
  - 2.1. Projekti "Rregullimi i trotuareve, hapësirave publike dhe ndriçim publik në fshatrat: Rubofc i madh, Rubofc i vogël dhe Kojskë" në komunën e Lipjanit në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.2. Projekti "Vendosja e ndriçimit publik në fshatrat Kuzmin, Sllatinë e Madhe, Harilaq, Vragoli, Miradi e Poshtme dhe Bardh i Madh - Fushë Kosovë" në komunën e Fushë Kosovës në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.3. Projekti "Rregullimi i hapësirave publike-shesheve" në komunën e Gjilanit në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.4. Projekti "Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik dhe ngritja e nivelit të shërbimit" në komunën e Gjakovës në vlerë prej 65,000.00 €;
  - 2.5. Projekti "Zgjerimi i ndriçimit publik në Kushtovë" në komunën e Mitrovicë e Jugut në vlerë prej 50,000.00 €;
  - 2.6. Projekti "Pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve" në komunën e Klinës në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.7. Projekti "Meremetimi i hyrjeve dhe objekteve banesore" në komunën e Podujevës në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.8. Projekti "Ndërtimi i parkut dhe këndit të lojërave në Tofaj" në komunën e Junikut në vlerë prej 45,000.00 €;
  - 2.9. Projekti "Asfaltimi i rrugëve në komunën e Istogut" në komunën e Istogut në vlerë prej 80,000.00 €;

- 2.10. Projekti "Ndriçimi në lagjen Dradania 1-Dardania 2, lagjen e Zabelit tek rru. E Valbonës, lagjen Bellopoj" rr. Shpetim Bojku, në fshatin Novosellë, fshati Ruhotë, lagjia "Zymberaj", "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi në fshatin Vitomericë rajoni i III-të rruga kryesore" në komunën e Pejës në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.11. Projekti "Ndriçim dhe hapësira të gjelberta" në komunën e Prizrenit në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.12. Projekti "Rindërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Pridvorica dhe ndërtimi i ndriçimit rrugor në fshatin Donji Krnjin" në komunën e Leposaviqit në vlerë prej 99,000.00 €;
  - 2.13. Projekti "Rregullimi i parterit/katit përdhes të objektit të Qendrës Rinore me lidhje në rrjetin e tensionit të ulët dhe pajisjen e ndërtesës" në komunën e Zveqanit në vlerë prej 104,000.00 €;
  - 2.14. Projekti "Ndërtimi i objekteve rekreativo-sportive dhe përmirësimi i cilësisë së ujit të lumi Iber në komunën e Zubin Potokut" në komunën e Zubinpotokut në vlerë prej 347,000.00 €;
  - 2.15. Projekti "Mbushja, ngjeshja dhe rrafshimi i rrugëve bujqësore në territorin e komunës së Parteshit" në komunën e Partesh në vlerë prej 50,000.00 €;
  - 2.16. Projekti "Reabilitimi i rrugës Lipjan Rubofc" në komunën e Lipjanit në vlerë prej 50,000.00 €;
  - 2.17. Projekti "Ndriçimi i fshatrave, shtrirja e rrugëve me kubëza dhe rregullimi i parqeve" në komunën e Prizrenit në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.18. Projekti "Asfaltimi i parkingut të objektit administrativ në komunës se Graçanicës" në komunën e Graçanicës në vlerë prej 40,000.00 €;
  - 2.19. Projekti "Rindërtimi dhe përmirësimi i ndriçimit publik në Graçanicë" në komunën e Graçanicës në vlerë prej 30,000.00 €;
  - 2.20. Projekti "Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferikë në rr."Lekë Dukagjini - Dardani-Gjakovë" në komunën e Gjakovës në vlerë prej 80,000.00 €;
  - 2.21. Projekti "Zgjerimi i ndriçimit publik në lagjen 2 Korriku dhe lagjen e Romëve" në komunën e Mitrovicë e Jugut në vlerë prej 74,888.00 €;
  - 2.22. Projekti "Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse në lagjen REA" në komunën e Podujevës në vlerë prej 70,000.00 €;
  - 2.23. Projekti "Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve lokale në Mamushë" në komunën e Mamushës në vlerë prej 170,000.00 €;
  - 2.24. Projekti "Asfaltimi i rrugës Perëndimi në Gurrakoc" në komunën e Istogut në vlerë prej 31,000.00 €.
3. Obligohet Ministria e Financave, punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë